



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 62/09

Prishtinë, më 21.10.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Armend Zemaj, Müfera Şinik.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Myrvete Pantina, Suzana Novobërdaliu, Hajdin Abazi, dhe Naser Osmani.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli.**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Ahmet Shala – Ministër i MEF-it, Besim Beqaj –Kryesues i Bordit të TKPK-së, pjesëmarrës nga GTZ, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, USAID, KDI.**

Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara dt. 7.10.2009;**
- 3. Dhënia e sqarimeve nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave lidhur me miratimin e nivelit të pagave të personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil
I ftuar : z. Ahmet Shala , Ministër i MEF-it;**
- 4. Shqyrtimi i kërkesës nr. 981/09 dt. 01.10.2009 së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm;**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 1004/09 dt. 08.10.2009 së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për aprovimin e një punëtori shtesë për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**
- 6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2723/Do-1719 dt. 05.10.2009 së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e uljes së taksës administrative
I ftuar : z. Besim Beqaj, Kryesues i Bordit Udhëheqës të TKPK-së;**

7. **Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-170 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, propozoi që pika e gjashtë e rendit të ditës të bëhet pika e tretë, dhe në vazhdim të bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

Propozimi u përkrah njëzëri dhe rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara dt. 7.10.2009

Kosara Nikolić, theksoi se në diskutimin e saj për pikën e tretë të rendit të ditës, nuk kam thënë i'u është ndryshuar destinimi, por ridestinimi. Ndërsa në diskutimin e saj për pikën e pestë, ka vlerësuar se të drejtat in rem janë të rregulluara me Ligjin për të Drejtat Sendore e jo siç është përkthyer serbisht në Ligjin për të Drejtat Sociale.

Kryesuesi, konstatoi se procesverbalet nga mbledhja e kaluar dt. 7.10.2009, miratohet me vërejtjet e znj. Kosara Nikolić.

3. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/2723/Do-1719 dt. 05.10.2009 së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e uljes së taksës administrative

Kryesuesi, theksoi se përkundër krizës globale financiare, trusti ka propozuar uljen e taksës administrative, e cila nuk ishte miratuar herën e kaluar nga Kuvendi për shkak të mungesës së bordit dhe shkaqeve tjera politike. Ulja e taksës është në të mirën e kontribuesve, të cilët i ngarkon ajo.

Besim Beqaj, theksoi se së bashku me kërkesën për uljen e taksës menaxhuese kemi bashkangjitur edhe buxhetin 2010. Parashihet që në vitin 2010 të kemi nën menaxhim 409 milion €. Nga projeksionet buxhetore për këtë vit, trusti pritet të gjenerojë të hyra prej 3.2 milion euro, ndërsa buxheti i miratuar është rreth 2.7 milion €. Nga këto parashikime kemi bërë ulje të shpenzimeve operative të trustit dhe rritje të shpenzimeve për aset menaxherët (60% e mjeteve për aset menaxherët). Qëllimi i zbritjes së taksës është ngarkesa sa më e pakët e kontribuesve pensional. Nga humbjet janë rikthyer afro 50 mili€ të vlerës së aseteve.

Haki Shatri, mbështeti propozimin për uljen e taksës menaxhuese. Megjithatë duke pasur parasysh faktin se mund të ketë më tepër të hyra se sa janë planifikuara, pyeti a do të mund të propozonit ulje të taksës edhe më të ulët (psh. 0.70%)? Propozoi që komisioni të rekomandoj Kuvendit miratimin e një "rezerve buxhetore" për nevojat e trustit për t'iu përgjigjur krizës së mundshme financiare, dhe të mos i lehet hapësirë trustit të veprojë pa vendim të Kuvendit.

Besa Gaxherri, theksoi se është kënaqësi që tashmë trusti e ka bordin të zgjedhur. Sa i përket kërkesës për uljen e taksës menaxhuese, përkrahu mendimin për krijimin e një rezerve buxhetore për trustin, si garant ndaj krizës së tregjeve financiare. Pyeti sa përqind është bërë kompenzimi i pensionistëve?

Safete Hadërgjonaj, vlerësoi kompletimin e bordit të TKPK-së, në mungesës të së cilit, si dhe për shkaqe tjera politike, vitin e kaluar taksa menaxhuese nuk ishte miratuar në Kuvend. Mbështeti propozimin për uljen e kësaj takse menaxhuese për vitin 2010. Nëse është nevoja të japim edhe sqarim në Kuvend, sepse në fakt kemi të bëjmë me ulje të buxhetit dhe zbritje të ngarkesës në mjetet kontribuesve pensional.

Besim Beqaj, theksoi se në fillim kemi menduar të propozojmë uljen e taksës në 0.70%, por për shkak të turbulencave që mund të shkaktohen në tregjet financiare, kemi lënë hapësirë menaxhmentit për të vepruar. Ndërkaq nëse kemi tepriçë të mjeteve buxhetore, ato do t'iu kthehen kontribuesve pensional. Nga Qershori deri më tani vlera e kompensimeve për kontribuesit arininë në 400.000 €, dhe pritjet që deri në fund të vitit të jetë 800.000€.

Armend Zemaj, theksoi se propozimi për uljen e taksës menaxhuese është e arsyeshme, kur dihet shtimi i numrit të kontribuesve pensional. Duke pasur parasysh faktin se kemi një parashikimi më të madh të hyrave (500.000€), atëherë edhe për hirë të transparencës do të ishte mirë të krijohej një rezervë buxhetore, dhe gjatë vitit 2010 të rishikohet se sa janë realizuar projeksionet buxhetore. Kjo edhe për faktin që ne të jemi të informuar direkt për gjendje e trustit, dhe jo të marrim informacione nga jashtë.

Kryesuesi, nga buxheti i vitit 2010, shifet se në të gjitha linjat ka ulje, me përjashtim, të korrespondenca me kontribuues, mirëmbajtje dhe shpenzime tjera. Kemi lëvizje pozitive në krahasim me vitet e kaluara. Kemi ulje të buxhetit për paga dhe mëditje për bordin udhëheqës. Nëse buxheti përfundon suficit apo edhe deficit do të veprohet sipas ligjit.

Besim Beqaj, në përgjigjen e pyetjeve, theksoi se që në takimi e parë të bordit, është marrë vendim për ulje të shpenzimeve operacionale. Dhe si rezultat pagat e anëtarëve të bordit janë të njëjta me anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu është bërë edhe ulje e pagave të menaxherëve. Megjithatë ligji në fuqi (për të cilin kemi sugjeruar të ndryshohet) përcakton mënyrën e pagesës së punonjësve të trustit, dhe kjo bëhet në bazë të mesatares së organizmave të këtyllë që funksionojnë në tregjet rajonale. Në aspektin financiar ekziston një dallim në mes buxhetit dhe projeksioneve, në këtë drejtim rezerva “imagjinare” nuk po kërkohet të miratohet, ajo do t'iu kthehet kontribuesve. Përkundër rënies së aseteve prej 60 milion € në krahasim me vitin e kaluar, megjithatë kemi propozuar uljen e taksës në 0.80%.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Miratohet propozimi i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës administrative për qeverisjen e mjeteve të besuara të kursimeve pensionale nga 0.90% në 0.80% nga shuma e mjeteve me qëllim të operacionalizimit financiar, duke filluar nga 1 Janari i vitit 2010.

4. Dhënia e sqarimeve nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave lidhur me miratimin e nivelit të pagave të personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil

Kryesuesi, theksoi se arsyeja e ftesës së ministrit, ka të bëjë me dhënien e sqarimeve për vendimin e tij për pagat e personelit të AAC-së. Njëkohësisht edhe për të biseduar për problemet që ekzistojnë në laramanin e pagave në agjencionet e pavarura. Të shikohet mundësia e dhënies së propozimeve të përbashkëta për rregullimin e kësaj çështje.

Ahmet Shala, njoftoi se konform ligjit ka miratuar kërkesën buxhetore të AAC-së, të cilën e konsideron të lartë, por natyra e punës së këtij agjencioni dhe tregu që rregullon kanë kushtëzuar për nivelin e pagave të tyre. Nëse ekziston propozimi për të ndryshuar pagat e këtij agjencioni dhe nëse arrihet pajtimi me Ministrinë e Transportit, mund të bëhet zvogëlimi i buxhetit të tyre. Sa i përket idesë për rregullimin e pagave të agjencioneve të pavarura, theksoi se Ministria nuk ka bërë një ndërhyrje të këtrillë sepse ka menduar se është kompetencë e Kuvendit, por nëse kërkohet do të mbështesim plotësisht këtë propozim dhe MEF-i do të ofrojë ekspertizën e nevojshme.

Kryesuesi, për problemet e ekzekutimit të buxhetit të agjencioneve të pavarura, tregojnë edhe shembujt në praktikë, kur Ministria e Administratës Publike nuk ka ekzekutuar vendimet e Kuvendit. Një shqetësim të këtrillë e ka ngritur edhe ICO. Pagat e punonjësve të agjencioneve duhet të jenë në përputhje me tregun që rregullojnë, dhe në këtë drejtim duhet të bërë kategorizimi dhe nivelizimi i tyre. Nivelizimi të bëhet në bazë të punëve që kryejnë (psh. zyrtar i financave, i prokurimit, asistent, zyrtar ligjor, pastrues, shofer, etj) dhe të paguhen njësojë, pavarësisht në cilën agjencion apo institucion punojnë. Në këtë drejtim në përcaktimin e pagave të punonjësve të agjencioneve të pavarura, do të na ndihmonin edhe praktikrat e mësuara në seminarin e organizuar nga GTZ.

Armend Zemaj, mbështeti propozimin që bashkarisht Komsioni me MEF-in të rregullojnë çështjen e kategorizimit dhe nivelizimit të pagave për agjencionet e pavarura. Problemi duhet të kërkohet rregullativën ligjore, sepse aty janë defektet (këtë e dëshmon edhe vendimi i ministri të MEF-it për pagat e AAC-ës që është thirrur në ligj), duhet bërë ndryshimi dhe plotësimi këtyre ligjeve. Nuk do të duhej që zyrtari në një agjencion të paguhet shumëfishtë me tepër se zyrtari në institucione. Duhet të ruhen kuadrat deficitarë, por të kushtëzohen me dhënien e kontributit të tyre në institucione, dhe jo që të financohen studimet e tyre dhe më pas të lëshojnë punën. Njëkohësisht nuk duhet bërë krahasime me vendet tjera kur dihet se kanë nivel tjetër të zhvillimit ekonomik.

Haki Shatri, theksoi se komisioni duhet të kërktojë nga Qeveria miratimin e Ligjit për paga, që do të rregulloheshin këto çështje. Për AAC-në nuk mund të ndryshohet buxheti i tyre për këtë vit. Kërkojë që MEF-i të sjell një pasqyrë për gjendjen reale të pagave të këtyre agjencioneve që po diskutojmë dhe propozimin për rregullimin e tyre, përkatësisht kategorizimin e tyre, e që duhet të bëhet në tri nivele: niveli i parë - anëtarët e bordeve, niveli i dytë - shërbyesit civil dhe niveli i tretë - ekspertët deficitar. Propozimi do të ishte mirë të dërgohej para diskutimit të buxhetit të këtyre agjencioneve.

Haxhi Gashi nga USADI, theksoi se ideja që me vendim të rregullohet çështja e pagave të rregullatorëve është e paqëndrueshme, sepse vendimi nuk mund të jetë mbi ligjin. Propozoi që të nxirret ligji për pagat e punonjësve të rregullatorëve dhe agjencive të pavarura.

Besa Gaxherri, theksoi se duhet që shumë shpejt me ligjin për paga të rregullohet çështja e pagave të këtyre të agjencioneve dhe rregullatorëve të pavarur. Përndryshe do të duhej të rishqyrtohen dhe amendamentohen ligjet ekzistuese për këto çështje. Nuk duhet që të ulen pagat e tyre, por t'iu rriten edhe të tjerëve në përputhje me përgjegjësitë dhe obligimet e tyre. Kemi laramani të pagave, administrata Kuvendit nuk kanë paga dhe kushte të mira për punë që po ndikon edhe në efikasitetin e punëve. Përcaktimi i pagave duhet bërë me kritere, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat gjendemi.

Kosara Nikolić, u pajtua me propozimin që Komisioni së bashku me MEF-in të bëjnë një propozim për rregullimin e pagave të punonjësve të agjencioneve dhe rregullatorëve të pavarur, në mënyrë që ligjet e miratuara të zbatohen në praktikë. Një rekomandim nga MEF-i do të ndihmonte në trajtimin e kërkesave që na vijnë në komision.

Safete Hadërgjonaj, theksoi se mungesa e ligjit për paga po i sjell më së shumti probleme këtij komisioni, me rastin e përcaktimit të pagave të bordit të agjencioneve dhe rregullatorëve të pavarur.

Në mandatin e kaluar kemi marrë një vendim që anëtarët e bordit ë këtyre agjencioneve të kenë paga në nivel të deputetëve, por nuk ka qenë efektiv në praktik. Zgjidhja më e mirë është miratimi i ligjit për paga, dhe deri atëherë do të përballemi me këto probleme.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

- I. MEF-it të rishikojë vendimin për nivelin e pagave të personelit të Autoritetit të Aviacionit Civil
- II. I rekomandohet Qeverisë së Kosovës që në afatin e shkurtër kohor, të hartojë dhe dorëzojë në Kuvend, Ligjin për pagat e Rregullatorëve dhe Agjencioneve të Pavarura.

5. Shqyrtimi i kërkesës nr. 981/09 dt. 01.10.2009 së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi, theksoi se Komisioni i ka përkrahur kërkesat buxhetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me rastin e rishqyrtimi të buxhetit. Pasiqë të njëjtat i ka përkrahur edhe Ministria, do t'i rekomandojë Kuvendit për miratimin e saj, dhe më pas MEF-i të bëjë harmonizimin brenda tabelave buxhetore.

Haki Shatri, pasi që për shkak të kohës nuk mund të kemi rrije të numrit të punëtorëve brenda këtyre dy muajve të mbetur të vitit buxhetor, propozoi që në rekomandim të thuhet, miratohet numri i auditorëve shtesë dhe buxheti i tyre i nevojshëm.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ndarjen shtesë të mjeteve buxhetore për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.
- II. Ministria e Ekonomisë dhe Financave do të bëjë harmonizimin e kësaj kërkesë, brenda tabelave buxhetore të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009.

6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 1004/09 dt. 08.10.2009 së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për aprovimin e një punëtori shtesë për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesi, theksoi se kemi të bëjmë me një kërkesë të AKP-së për shtimin e një punëtori (pastrues), për të cilin nuk kërkohet buxhet shtesë.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- III. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të miratojë kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për rritjen e një punëtori shtesë për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pasi që e njëjta nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me raportin e Komisionit funksional - Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, me amendamente

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për projektligjin dhe amendament e komisionit funksional, lidhur me mundësin e implikimeve financiare të tyre.

Pasi që nuk kishte vërejtjeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjygjësi, dhe ka konstatuar se amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/L-170 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryesuesi, pasi që projektligji është miratuar në parim në Kuvend, propozoi që bartës në amendamentimin të këtij projektligji të jetë Teki Shala, që do të punojë në bashkëpunim me ekspertët e USADI-it, për të propozuar amendamentet në komision.

9. Të ndryshme

Kryesuesi, kërkoi nga grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit për tatimin në të ardhurat personale dhe nga grupi punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, së bashku me ekspertët e USADI-it, të bëjnë propozim amendamentet konkrete për komision.

Mbledhja përfundoi në ora 13:00

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Gani KOCI